

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
DIREKTORIA E BASHKESHTETIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE
PRISTINE

Postavljeno	05.02.2026
Org. led.	02-06/61-000
Prilog	1972126

PODURVET - PODUPITE

Registruje se u Opštini Podujevo / Municipality of Podujeva
02/04163
03.02.2026



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
Kompania regjionale "Pastrimi"

Me datë: 02.02.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur në mes:

Komunës së Podujevës më tej 'Komuna', me adresë në Rrugën "Nuhi Gashi" në Podujevë, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – Z. Shpetim Bulliqi

dhe

Kompanisë Rajonale për Mbeturinë "Pastrimi" SH.A, më tej "Kompania" me adresë në rrugën "Tahir Zajmi" Nr.5 në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Kryeshefi Ekzekutiv, Z. Petrit Regica

Neni I

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi në mes Komunës së Podujevës dhe Kompanisë Rajonale "Pastrimi" SH.A, është ofrimi i ndihmës për participim në pagesën e 6 (gjashtë) punëtorëve fizik sezonal të Kompanisë për periudhën prej 12 muajve (Prej muajt Shkurt 2026 deri në Shkurt 2027) për kryerjen e punëve në menaxhimin e mbeturinave, si në vijim:

2.1. Largimin e deponive ilegale;

2.2. Largimin e mbeturinave voluminoze;

2.3. Pastrimin e sipërfaqeve publike;

2.4. Punët tjera, varësisht nga nevoja në terren, për të ndihmuar Njësinë e Kompanisë në Podujevë në grumbullimin e mbeturinave.

Neni 2
Vlera e financimit

1. Vlera e përgjithshme për pagesën e punëtorëve sezonal, sipas neni 1 të kësaj marrëveshjeje është në shumë prej 36.000.00 €.
2. Në pagesën e punëtorëve sezonal, Komuna e Podujevës do të participoj me mjete financiare në shumë prej 18.000.00 €.
3. Në pagesën e punëtorëve sezonal, Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, do të participoj me mjete financiare në shumë prej 18.000.00 €
4. Paga mujore për 6 punëtorët sezonal sipas kësaj marrëveshjeje caktohet në shumë prej 500 € bruto në muaj për secilin punëtor për periudhën 12 mujore.

Neni 3
Obligimet e Komunës

1. Komuna e Podujevës obligohet që për pagesën e punëtorëve sezonal, sipas kësaj marrëveshjeje të siguroj mjete financiare në shumë prej 18.000.00 €, nga buxheti i Komunës.
2. Të caktoj një përfaqësues nga Komuna e Podujevës në cilësinë e mbikëqyrësit të realizimit të punëve në terren sipas kësaj marrëveshjeje.
3. Komuna e Podujevës mjetet financiare në shumë prej 18.000.00 €, do t'i transferoj në llogarin bankare të Kompanis Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A me nr. 1700200100051292 në NLB.

Neni 4
Obligimet e Kompanisë

1. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, obligimet që për pagesën e 6 punëtorëve fizik sezonal të siguroj mjete financiare në shumë prej 18.000.00 €, për ngritjen e kualitetit të grumbullimit të mbeturinave për interesin e përgjithshëm të qytetarëve.
2. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A – Njësia në Podujevë, në bashkëpunim me Komunën e Podujevës monitoron mbarëvajtjen e menaxhimit të mbeturinave dhe punëve tjera mjedisore në funksion të pastritit të hapësirave publike në terren.
3. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, duhet t'i dorëzoj raport me shkrim Komunës së Podujevës për realizimin e punëve në terren si dhe për shpenzimin e mjeteve të destinuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5
Zbatimi

Kjo Marrëveshje është e zbatueshme dhe e vlefshme deri në përmbyshjen e obligimeve nga të dyja palët.

Neni 6
Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet e krijuara nga Marrëveshja e Bashkëpunimit duhet të zgjidhen përmes bisedimeve midis palëve. Nëse dështojnë bisedimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët do t'i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 7
Numri i kopjeve

Marrëveshja e Bashkëpunimit është përpiluar në kopje identike dhe të mjaftueshme për secilen palë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Marrëveshja e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dy palët nënshkruese.

Nënshkruar më datë: 02.02.2026

